



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 5936 ProtElbasan më 16 /12/2024

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin NËNTOR 2024

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin NËNTOR 2024 gjithsej 83 familje me një fond gjithsej 222.000 lekë.
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit.
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka

Konfirmoi: D.Rroseni

Zv/Kryetari

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/12/ 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë ____/12/ 2024

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin NËNTOR 2024

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/12/2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin NËNTOR 2024 për 83 familje me një fond prej 222.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Përgj Kujdesit Social
Drejtori Juridik

D.Rroseni
A.Hoxha


Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE
AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
NENTOR 2024

I. Ndhma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Nentor 2024

Nentor	235 familje	fondi	1.048.503
Tetor	225 familje	fondi	1.001.224

Për muajin Nentor 2024 kemi 10 familje me shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 47.279 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Artur Henza (aplikon ne sistem)
2. Gjylie Limollari (ka dale ne pension)
3. Lirije Limollari (trajtohet me P.A.K)
4. Lirije Dushku (trajtohet me P.A.K)
5. Bukurije Çela (nuk paraqitet)
6. Shkelqim Shkalla (nuk paraqitet)

II. Ndhma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Nentor 2024

Nentor	83 familje	fondi	222.000
Tetor	95 familje	fondi	247.100

Për muajin Nentor 2024 kemi 12 familje më pak se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 25.100 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

1. Suela Vogli (trajtohet tek fondi 6%)
2. Agim Bajrami (aplikon në sistem)

3. Fatmir Kiptiu (aplikon ne sistem)
4. Bardhyl Muça (aplikon ne sistem)
5. Kastriot Raifi (aplikon ne sistem)
6. Besim Tashi (aplikon ne system)
7. Indrit Sinani (nuk paraqitet)
8. Sami Molla (nuk paraqitet)
9. Halim Budani (nuk paraqitet)
10. Jeran Sula (nuk paraqitet)
11. Rakip Beqiri (nuk paraqitet)
12. Behar Laloshi (nuk paraqitet)
13. Ruzhdi Kuka (nuk paraqitet)
14. Kujtim Zaimi (nuk paraqitet)
15. Artan Pema (nuk paraqitet)
16. Ymer Kasneci (nuk paraqitet)
17. Ismail Gjika (nuk paraqitet)
18. Azem Kryemadhi (nuk paraqitet)
19. Ilir Omeri (nuk paraqitet)
20. Gramoz Gaçe (nuk paraqitet)
21. Agron Çerri (nuk paraqitet)
22. Fluturim Muça (nuk paraqitet)
23. Albert Lushi (nuk paraqitet)
24. Flamur Baho (nuk paraqitet)
25. Gramoz Muça (nuk paraqitet)
26. Azem Çerri (nuk paraqitet)
27. Bujar Korra (aplikon ne sistem)
28. Xheladin Ruçi (aplikon ne sistem)

Përgjegjëse Sektori I vlerësimit dhe pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar

Miranda Duka



3/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. Prot. 5937Elbasan më 16 /12/2024

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin NËNTOR 2024
KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin NËNTOR 2024 ,
235 familje me një fond prej 1.048.503 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka

Pranoi: D.Rroseni

ZV/KRYETARI

ARMAND SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/12/2024

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/12/2024

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin NËNTOR 2024

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/12/2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin NËNTOR 2024 për 235 familje me një fond prej **1.048.503** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social
Drejtori Juridik

D.Roseni
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 5900 prot

Elbasan me 130/2024

RELACION

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.” dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”, Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar nëpërmjet punonjësve social të saj të Sektorit të Shtresave në nevojë dhe Moshës së tretë pasi shqyrtoi kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur për vendosje në shërbimin rezidencial për të moshuar në Qendrën Sociale Balashe të bashkisë Elbasan, paraqet për sistemim si më poshte:

1. I moshuari Z. Vasil Petro Qosja , i datëlindjes 22.10.1957, vendbanimi Elbasan, Lagje 5 Maji, me nr. ID F71022004S, propozohet për t’u vendosur në qendrën e përkujdesit social për të moshuar pasi është i vetmuar. Jeton prej vitesh i vetëm pasi bashkeshortja e ka braktisur po ashtu edhe i biri ka vite që nuk ka komunikim me të. I moshuari nuk ka shtëpi, ka jetuar prej vitesh në një barake tek shtëpia pritjes, por pasi atë ia prishen ka ngelur në rrugë. Me të ardhurat që ka nuk përballon dot shtëpi me qera dhe jetesën.
 2. I moshuari Z. Mustafa Zenel Kurti , i datëlindjes 04.07.1951, vendbanimi Bradashesh, me nr. ID F10704007L, propozohet për t’u vendosur në qendrën e përkujdesit social për të moshuar pasi është i vetmuar, i ve. Ka një djalë, i cili jeton prej 25 vitesh në Greqi, është me dializë. I moshuari nuk ka shtëpi dhe është në gjendje shumë të vështirë social- ekonomike.
- Në këto kushte të ndodhura Z. Vasil Petro Qosja dhe Z. Mustafa Zenel Kurti plotësojnë kriteret për tu akomoduar në azil.

Ky vendim i dërgohet Këshillit Bashkiak për vlerësim përfundimtar, bazuar në nenin 28 të ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

Duke ju falenderuar !

Konceptoi: Spec. Anduena Coku

Pranoi : Dr. Eltiona Kolla

Drejtor i përgjithshëm: Dorina Roseni

KRYETARI

Gledian LLatja

ME URDHER E POROSI

Zv. Kryetari Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot

Elbasan më / /2024

PROJEKT-VENDIM

Nr ____/datë / /2024

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / /2024 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.”, neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”,

VENDOSI

Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe, në shërbimin rezidencial si më poshtë:

- I. I moshuari Z. I moshuari Z. Vasil Petro Qosja, i datëlindjes 22.10.1957, vendbanimi Elbasan, Lagje 5 Maji, me nr. ID F71022004S.
- II. I moshuari Z. Mustafa Zenel Kurti , i datëlindjes 04.07.1951, vendbanimi Bradashesh, me nr. ID F10704007L.
- III. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes sociale si dhe Drejtoria e Qendrës Sociale Balashe.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori i Përgjithshëm

D. Roseni

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Buxhet-Finance

A.Merkja



5.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E PYJEVE, BUJQËSISË DHE MJEDISIT
DREJTORIA E MJEDISIT BUJQËSISË DHE VETERINARISË
INSPEKTORATI I MJEDISIT

Nr. 5828 prot.Elbasan, më 12.12.2024

RELACION

“Për miratimin e Planit Vendor të Mbrojtjes së Mjedisit 2025 – 2026”.

Të nderuar këshilltarë,

KËSHILLIT BASHKIAK

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr 9974 date 12.07.2007 “ Per vlersimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis“ si dhe Urdhërit Nr 4001 datë 29.08.2024 i Kryetarit të Bashkisë “ Për Ngritjen e grupi të punës për hartimin e planit vendor të mjedisit për periudhën 2025 – 2026 “ ju bëjmë me dije se :

Bashkia në kuader te masave për mbrojtjen, përmirësimin dhe zhvillimit të një mjedisi sa më të qëndrueshëm,marrjen e masave për reduktimi i emtimeve në ajër me 40% deri në vitin 2030, dhe orientimi i këtyre masave drejt zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike si dhe nga detyrimet ligjore që lindin, ka përgatitur këtë plan mjedisor për miratim nga këshilli bashkiak.

Ky plan mjedisor orienton politikat e Bashkisë për mjedisin, investimet e nevojshme, masat emergjente dhe afatmesme për ruajtjen dhe përmirësimin e klimës mjedisore në territorin e Bashkisë Elbasan,duke patur parasysh edhe rritjen me ritme të shpejta të turizmit në 3 vitet e fundit.

Duke Ju falenderuar.

Konceptoi: Përgj. Inspektoriatit. I. Dybeli

Pranoi: Drejtori Mjedisit. E. Hazizolli


Konfirmoi : Juristi. K.Totoshi

Miratoi: Dr. Përgjithshëm. Sh . Çullhaj

ZV / KRYETAR

Aulona BYLYKBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E PYJEVE, BUJQESISE DHE MJEDISIT
DREJTORIA E MJEDISIT BUJQESISE DHE VETERINARISE
INSPEKTORATI I MJEDISIT



PLANI VENDOR I MBROJTJES SE MJEDISIT

2025-2026

Fjala e kryetarit

Të nderuar Këshilltar e Bashkëqytetarë!

Procesi i Planit Vendor i Mbrojtjes së Mjedisit, është një objektiv parësor i Bashkisë Elbasan. Në territorin e Bashkisë gjenden burime dhe resurse të rëndësishme natyrore të cilat kanë statusin e zonave të mbrojtura; si Qafa e Bushit në Njësinë Administrative Labinot Mal, zona e Sopotit pjesërisht në Njësin Administrative Zavalinë, zona e burimeve të Llixhave në Njësinë Administrative Tregan, zona Byshekut Njësia Administrative Shushicë, Kalaja e Qytetit, Zona Arkeologjike e qytetit, Zona e Bazilikës Paleokristiane, Xhamia e Nazireshtës etj. Si dhe një rrjet hidrik i pasur me jetë.

Zhvillimi i turizmit, ekonomisë së gjelbër, si dhe qenia sa më miqësor me mjedisin, përbëjnë potenciale të rëndësishme për zhvillimin e nivelit të jetesës së qytetarëve Elbasanas. Këto veprimtari do të zhvillohen duke ruajtur e konsoliduar këto burime natyrore të rëndësishme nëpërmjet një mjedisi më të pastër dhe shfrytëzimi racional të tyre.

Plani Vendor i Mbrojtjes së Mjedisit është një sfidë shumë ambicioze, i cili kërkon përkushtim nga të gjithë aktorët si dhe një kusht që duhet përmbushur domosdoshmërisht për të mundur një mjedis të pastër dhe ekonomi të gjelbër, turizëm elitare të qëndrueshme e cila kontribuon në arritjen e qëllimeve reciproke si:

- Rimëkëmbjen ekonomike
- Uljen e varfërisë
- Uljen e emetimeve të CO2 dhe mos degradimin e ekosistemit.

Nëpërmjet Planit Vendor të Mbrojtjes së Mjedisit 2025-2026, Bashkia do të realizojë misionin e saj për përmirësimin e jetës së qytetarëve, duke e patur prioritet kryesor parandalimin e ndotjes së mjedisit, sigurimin e një mjedisi të pastër, të shëndetshëm, shlodhës dhe argëtues për qytetarët duke ju afruar standardeve të BE-së.

Ne duhet ti përmbahemi detyrimeve, angazhimeve dhe objektiva të marra deri në vitin 2030 për reduktimin e gazeve serë deri në masën 40%.

Përmbushja e këtyre objektivave është një sfidë për Bashkinë, ajo kërkon kohë, përkushtimin tonë por edhe të qytetarëve Elbasanas.

Bashkia nuk do të kursejë për të investuar në edukimin, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen qytetare, ashtu sikundër ne do të bëjmë transparente të gjitha vendimet tona, për të mundur një rol sa më të madh të qytetarëve në zbatimin e këtij Plani.

Nëpërmjet këtij mesazhi i bëj thirrje të zgjedhurve vendor, Administratës Vendore dhe Qendrore në Elbasan, si dhe të gjithë qytetarëve që me përkushtim të bashkëpunojmë të gjithë së bashku për ta bërë këtë Plan një realitet dhe ta kthejmë Elbasanin në një Bashki të gjelbër, me ajër të pastër, miqësore me mjedisin dhe me një atraksion turistik.

**Me respekt
Kryetari i Bashkisë Elbasan
Gledian Llatja**

Përmbajtja:

1. Kuadri i hartimit të Planit vendor të mbrojtjes së mjedisit
2. Legjislacioni
3. Kushtet e vendit
 - Pozicioni gjeografik
 - Klima
 - Hidrografia
 - Përdorimi i tokës
 - Ish zona Industriale
 - Demografia
4. Ndotja e ajrit
 - Projekti “Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit”
 - Origjina e ndotjes
 - Vlerësimi i cilësisë së ajrit
 - Masat
 - Zhurma
5. Edukimi publik
6. Mbrojtja e mjedisit nga shkarkimet industriale
7. Pastrimi i territorit ne juridiksion te Bashkise Elbasan
8. Mjedisi i gjelber
9. Uji i pijshem
10. Kanalizimet e ujrave te zeza e te bardha
11. Ndotja akustike
12. Transporti dhe levizshmeria
13. Parandalimi i situatave emergjente natyrore dhe i semundjeve epidemike dhe infektive
14. Mbi Inspektoriatin dhe sherbimin veterinar
15. Mbi Inspektoriatn e mjedisit
16. Promovimi i turizmit

1. Kuadri i hartimit të Planit vendor të mbrojtjes së mjedisit

Sfidat e sotme mjedisore janë vendosur në fokusin e politikave në mbarë botën, duke përfshirë edhe institucionin tonë. Nëse koncepti i mirëqënies ka qenë më parë i lidhur ngushtë me të mirat materiale dhe zhvillimin ekonomik, sot është i lidhur me aspekte të tjera si shëndeti, mjedisi, marrëdhëniet shoqërore, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me perceptimin subjektiv të çdo individi.

Kushtet e jetesës së njeriut janë të varura nga ekosistemi në të cilin ai jeton, kështu që është e nevojshme që të mbrojmë dhe të ruajmë mjedisin, në mënyrë që të sigurojmë një cilësi jete të qëndrueshme për gjeneratat e së tashmes dhe së ardhmes.

Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimit të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimale të lejueshëm nga BE mbetet sfida kryesore e bashkisë sonë.

Motoja “*Ajër i pastër, jetë e shëndetshme*” si dhe jetëzimi i projektit “*Mushkëri të gjelbërta për Qytetet tona*” është formë alternative për identifikimin dhe monitorimin e treguesve të cilësisë së ajrit për realizimin e planit vendor për ndotjen e ajrit në bashkinë Elbasan.

Bashkia Elbasan me qëllim realizimin e objektivave të saj, ka punuar dhe vazhdon të punojë në zbatim të politikave progresiste dhe në referim të standarteve të BE-se në fushën e mjedisit.

Plani vendor i mbrojtjes së mjedisit është një punë sistematike, e cila analizon dhe vlerëson burimet e ndotjes së mjedisit, dhe ndikimin e secilit burim në mjedis, me qëllim parashikimin e masave të nevojshme për reduktimin, apo eliminimin e ndotësve në mjedis, duke u bazuar në standartet Kombëtare dhe Europiane, lidhur ngushtë me zhvillimin urban dhe infrastrukturën, për mirëqënie sociale si dhe rritjen ekonomike.

Ky plan ka nevojë për zhvillimin e një sërë programesh, masash menaxheriale dhe bashkëpunim të shumë institucioneve dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në mënyrë që të përmbushë detyrimet ligjore dhe të garantohet mbrojtja e mjedisit, shëndetit publik dhe përmirësimi i cilësisë së jetës.

2.LEGJISLACIONI

Kryerja e Planit Vendor të Mbrojtjes së Mjedisit mbështetet në **aktet ligjore** si më poshtë:

- Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji Nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, bazuar në direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 2008/50/EC datë 21.05.2008 “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër në Europë” numri Celex 32008L0050, Fletorja zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 152 datë 11.06.2008 .
- VKM Nr.594 datë 10.09.2014 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit”.
- Ligjin Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar
- Ligjin Nr. 8224 datë 15.05.1997 “ Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake dhe të ish Komunës”, i ndryshuar.
- V.K.M. Nr. 1189 datë 18.11.2009 “ Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- V.K.M. Nr. 379 datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm””
- Ligji Nr. 7643 datë 02.12.1992 “ Për inspektoriatin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar .
- Ligji Nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007 “ Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis” i ndryshuar.
- V.K.B nr 62, dt.19.04.2018 “ Per miratimin e planit te veprimit per zhurmat”.
- V.K.B nr 66, dt.23.05.2019 “ Per miratimin e venddepozitimit te perkohshem te mbetjeve te ngurta inerte “.
- V.K.B nr 201, dt. 24.12.2019“ Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025”
- VKB nr. 34, datë 25.03.2016 "Për Gjobat që do të aplikohen për dëmrimet e mjedisit, të hapsirave të gjelbërta dhe rrjetit rrugor të Bashkisë.

3.KUSHTET E VENDIT

Pozicioni gjeografik

Bashkia Elbasan shtrihet në Shqipërinë Qendrore dhe është qyteti i tretë më i madh në vend me një sipërfaqe prej 872 km² dhe pozicion strategjik, pasi përshkohet nga rrugë të rëndësishme kombëtare. Bashkia është lehtësisht e aksesueshme për shkak të distancave të shkurtra nga infrastrukurat kryesore (aeroporti, porti dhe pika kufitare.)

Territori i saj është përgjithësisht reliev kodrinor-fushor, në pjesën perëndimore dhe qendrore dhe pjesërisht kodrinor-malor, në verilindje dhe juglindje.

Zona fushore ndodhet përgjatë luginave të lumenjve kryesorë, ku sipërfaqen më të madhe e ka ajo e Lumit Shkumbin. Lartësia maksimale në këtë zonë arrin 70-128 metra mbi nivelin e detit. Pranë përroit të Zaranikës ndodhet masivi kodrinor i Letanit, Rrilës, Preçës së Poshtëm.

Niveli i pjerrësive fillon nga 7.13% deri në 100%.

Zona fushore në pjesën qendrore, karakterizohet nga një pjerrësi e ulët, që varion nga 0 deri në 16.93%. Zonat e buta kodrinore kanë pjerrësi që shkojnë deri në 49.91%.

Klima

Përshkrimi i elementëve klimatike të zonës së Elbasanit i referohet studimit mbi “Veçoritë Hidrometeorologjike dhe Mjedisore” të qytetit të Elbasanit i përgatitur nga Insituti i Hidrometeorologjisë, në mars të vitit 2005. Sipas ndarjes klimatike të Shqipërisë, zona e Elbasanit bën pjesë në zonën mesdhetare kodrinore dhe nën zonën mesdhetare kodrinore qendrore. Larmia e formave të relievit dhe shtrirja e gjërë veri-jug ndikojnë në regjimin e elementëve klimatike. Temperatura mesatare e ajrit varion nga 6.7°C në janar deri në 23.4°C në korrik. Temperatura mesatare maksimale varion nga 11°C në janar deri në 31.2 °C në korrik. Temperatura mesatare minimale varion nga 2.2 °C në janar deri në 15.8 °C në korrik. Temperatura minimale absolute është regjistruar në janar të vitit 1968 me -7.5 °C dhe ajo maksimale absolute është regjistruar në korrik 1988 me 42 °C.

Era është një tjetër element i rëndësishëm klimatik për të cilin në përgjithësi mund të thuhet se zona e Elbasanit karakterizohet nga vlera të larta të qetësisë (rreth 53%) dhe shpejtësi minimale 1.2m/s gjatë verës dhe shpejtësi mesatare maksimale 2.1-2.4 m/s në dimër. Erërat që fryjnë nga verilindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me 4.7m/s.

Përsa i përket reshjeve, pjesa më e madhe e tyre bien në gjysmën e dytë të vitit dhe më pak në gjysmën e ngrohtë, për shkak të aktivitetit ciklonik. Konkretisht gjatë gjysmës së ftohtë bie 65,8% e shumës vjetore të reshjeve dhe gjatë gjysmës tjetër bie 34,2%. Shuma vjetore e reshjeve është 1148mm, ndërsa maksimumi 24 orë i reshjeve është 134,9 mm. Reshjet në formë borë janë dukuri e rrallë për zonën e Elbasanit. Numri i ditëve me shtresë bore është i ulët dhe ka një vlerë mesatare prej 1.2 ditë në vit.

Regjimi i rrezatimit karakterizohet nga një sasi vjetore e rrezatimit diellor prej 1448.5 kwh/ m², ku vlera më e ulët haset në dhjetor me 50.1 kwh/ m² dhe vlera më e lartë në korrik me 202.1 kwh/ m². Gjatë vitit hasen mesatarisht 2442 orë me diell. Muaji me numrin më të lartë të orëve me diell është përsëri korriku (326 orë), ndërsa dhjetori ka vetëm 111 orë me diell, çka është dhe vlera më e ulët gjatë vitit.

Hidrografia

Sasia mesatare e reshjeve vjetore prej 1210 mm në vit furnizon një rrjet hidrografik të pasur. Rrjedhjet sipërfaqore më të rëndësishme janë Lumi i Shkumbinit, Përroi i Zaranikës dhe i Manasderes.

Lumi Shkumbin me një gjatësi prej 181 km ushqehet nga 3 lloje burimesh: ujra të shiut, ujra të borës dhe ujra nëntokësore. Kjo diktohet nga kushtet klimaterike, tokësore dhe gjeologjike. Përbërja petrografike ka ndryshime të mëdha në pozicione të ndryshme të rrjedhjes së Shkumbinit. Deri në Elbasan përbërja është: Magmatike 10-35%; Karbonare 40-30%; Silicore (Kuarcore) 50-35%.

Shkumbini ka një gjatësi të madhe, me sipërfaqe të konsiderueshme të pellgut ujëmbledhës. Sipërfaqja e pellgut topografik deri në derdhje është 2442 km². Përsa i përket rrjedhjes mesatare vjetore, vlerësimi është bërë duke u mbështetur në të dhënat e vend matjeve Shkumbini-Murrash dhe Shkumbini-Papër për periudhën 1950-2000.

Vrojtime janë bërë gjithashtu për përrrenjtë Zaranika dhe Kusha. Nga analiza e informacionit shumë vjeçar del se rrjedhja ka një shpërndarje stinore e cila kulmon në stinën e pranverës me 35-40% të rrjedhjes vjetore. Më pas vjen dimri me 31-35%, vjeshta me 14-16% dhe vera me 13-15%. Nëse i referohemi shpërndarjes mujore, muaji më me shumë ujë është prilli me 10-14% të rrjedhjeve vjetore dhe muaji më me pak ujë është gushti me 1.9-2% të saj.

Qyteti i Elbasanit ka dy përrrenjë të konsiderueshëm; në lindje përroi i Manasderes dhe në perëndim përroi i zaranikës. Përroi i zaranikës është cilësuar si përrua i rrëmbyeshëm që gjithmonë ka shkaktuar probleme në përmbajtje në qytet. Ai ka prurje të mëdha të gurëve dhe të inerteve. Që nga viti 1965 shtrati i tij është kufizuar dhe është ndërprerë nga ndërtimi i digës në vendin ku ky përrua hyn në qytet dhe sistemimit të kanalit i cili kalon deri në bashkimin e këtij përroi me lumin Shkumbin. Përroi i Manasderes gjatë gjithë gjatësisë së tij nëpër qytet kalon në një kanal betoni që funksionon normalisht. Në dalje të qytetit ky përrua krijon gjithmonë probleme sepse del nga shtrati i tij, që është tepër i ngushtë dhe i ngarkuar me prurje dhe mbetje urbane të zonave informale në shtratin e përroit me vepra arti, ura veshje, tuba shkarkimesh etj dhe ndalimin e shkarkimeve të ujrave të zeza direkt në të. Gjatë periudhës së verës të dy këta përrenj kanë prurje të vogla dhe pothuajse janë të thatë.

Përdorimi i Tokës

Sipas analizës territoriale, sistemi natyror zë rreth 72% të territorit (628.6km²) dhe është i përqëndruar në skajet e territorit të bashkisë, duke qenë se këto zona përshkruhen nga sisteme kodrinore dhe pjesërisht malore. Po ashtu, sistemi natyror ndërthuret me zonat e mbrojtura që ndodhen në territorin e saj. Sistemi bujqësor rënditet i dyti, duke zënë afërsisht 21% të territorit (176.7km²) dhe ndodhet përgjatë shtratit të Lumit Shkumbin, në fushën e Elbasanit, zonë në të cilën janë përqëndruar zhvillimet urbane, industriale dhe ekonomike. Në pjesën jugore të territorit, sistemi urban ndërthuret me sistemin natyror dhe me sistemin urban. Sistemi urban, i cili zë 3.5%, është përqëndruar kryesisht në qytetin e Elbasanit.


Ish zona Industriale

Në bashkinë Elbasan, për shkak të industrisë së rëndë janë vendosur operatorë të mëdhenj industrial, si: “KRUM Internacional”, “RBH BELINE”, ”GSA”, “CCALB Shkrija e Plumbit”, “Impuls Industri”, “ECF Cement Factory”, uzina e “Karbonit”, Frabrika e “Tullave”, Uzina e “Lëndëve Plasëse” në Mjekës, Uzina e shkrijes së ferrokromit “Alb-Chrom”, ndërmarrja e furnizimit “Industri Miniera” etj, dhe veprimtaritë e tyre kanë ndikime serioze në mjedis.

Zona industriale e qytetit të Elbasanit, e pozicionuar në periferi në një distancë në vijë ajrore prej 4 km, është e shtrirë në një sipërfaqe prej rreth “160 ha”. Përveç këtyre subjekteve, në këtë zonë

ushtrinë aktivitet edhe një numer i madh subjektsh me aktivitet më të vogël, por me ndikim në mjedis si (riciklime baterish, përpunime metalesh (fonderi), riciklime plastike, inceneratorë të mbetjeve spitalore, etj).

Më poshtë paraqitet një hartë ku tregon përdorimin e tokës në Elbasan



Demografia

Analiza e të dhënave demografike të Bashkisë Elbasan tregon rënie të popullsisë së grupmoshave më të reja, veçanërisht atyne nën 10 vjec, gjate viteve të fundit. Kjo prirje mund të tregojë ulje të numrit të lindjeve ose ndryshim të mundshëm të preferencave të popullsisë për planifikim familjar. Nga ana tjetër vihet re qendrueshmeri te grupet në moshe pune (20-59), që mund të tregojë fuqi punëtore relativisht të qëndrueshme. Qëndrueshmeria e grupit në moshë pune tregon dividentin demografik që mund të shkaktojë rritje ekonomike në Bashkinë Elbasan.

4.Ndotja e ajrit

Ligji nr 162/2014 “Për mbrotjen e cilësisë së ajrit në mjedis” është kuadri ligjor kryesor që mbështet menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.

Fokusi kryesor i tij është të përmisojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet integritit të çështjes së mbrotjes së ajrit në politika të tjera si dhe përcaktimit të kërkesave për pakësimin e shkarkimeve, monitorimin, vlerësimin, planet e cilësisë së ajrit dhe për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis. Edhe në bashkinë Elbasan gjendja e cilësisë së mjedisit është një ndër çështjet mjedisore më kritike që prek jetën e përditshme të çdo qytetari dhe ka të bëjë me mirëqeverisjen në nivel vendor. Bashkia synon arritjen e objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve ,për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimal të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë. Burimet e ndotjes janë sipas sektorëve të ekonomisë dhe ndotësve të tjerë specifike.

Burimet e ndotjes

Burimet e ndotjes së cilësisë së ajrit janë të ndara në burime pikësore dhe burime të shpërndara.

Burimet pikësore të ndotjes së ajrit janë burime stacionare të shkarkimeve të ajrit, si fabrika, termocentrale, fonderi, rafineri dhe impiante kimike. Ndikimet e tyre janë kryesisht të lokalizuara edhe pse varen nga shpejtësia, forca dhe drejtimi i erës, ndikimet negative të tyre mund të zbulohen në distanca të mëdha nga pikat e tyre të origjinës. Burim i lokalizuar është çdo burim i vetëm i indentifikueshëm i ndotjes nga impiantet e mëdha të palëvizshme të tilla si : impiantet e djegies së lëndëve djegëse fosile, furnaltat, kaldajat industriale, rafineritë e naftës dhe ndërmarrjet e prodhimit.

Burimet e shpërndara të ndotjes në ajër ndodhin nga burime të ndryshme të shpërndara të tilla si ; mjetet e transportit rrugor, ngrohja e banesave, bujqësia dhe biznesi i vogël. Ndotja nga burimet e shpërndara ndodh në zona të mëdha dhe në mënyrë individuale nuk mund të jetë shqetësuese, por në kombinim me burime të tjera të shpërndara mund të ketë ndikim në mjedis, ndotësit e shpërndarë që lëshohen në ajër përfshijnë oksidet e azotit, oksidet e squfurit, monoksidi i karbonit amoniaku dhe grimca e pluhurit.

Transporti

Përmirësimi i infrastrukturës së lëvizjes për të mbështetur lëvizshmërinë efektive ,ndërlidhjen më të mire dhe reduktimin e bllokimeve të trafikut në Bashkinë Elbasan.

Ndërhyrjet trajtojnë :përforcimin e lidhjeve midis qendrave kryesore urbane me qytetin e Elbasanit,përforcimin e bajpasit të Elasanit për të reduktuar trafikun ndërqytetas,përmirësimin e transportit publik ndërqytetas,transportit të ndryshëm dhe transportit të mallrave,përmirësimin e transportit public ndërqytetas përmes ndërhyrjeve te internarët për stacionet e autobusëve /furgonave përgjatë rrugëve lidhëse,rregullimin e trafikut të qytetit duke rehabilituar rrerthrotullimet/kryqëzimet kryesore në qytet,promovimin e investimeve publike dhe private në fushën e lëvizmërisë së gjelbër (Green Mobility)për këmbësorët dhe biçikletat,rrugët natyrore dhe recreative.

Spektori i transporteve është një ndër kontribuesit kryesore përsa u përket shkarkimeve të përgjithshme në ajër

Dendësia e trafikut, viti i prodhimit të automjeteve si dhe mungesa e kontrollit të shkarkimeve të gazta nga automjetet cojnë në rritjen e shkarkimeve të gazrave dhe pluhurit (PM 2,5; PM10, zn; mg; pb; co; zn; cr) duke reduktuar cilësinë e ajrit të mjedisit. Shkarkimet e Co2 nga transporti përmbajnë emetime nga djegia e karburanteve për të gjitha aktivitetet e transportit për shkak të cilësisë së lëndës djegëse që përdorin duke rritur përqëndrimin e SO2 të çliruar. Përqëndrime më të larta të grimcave SO2, të oksideve të azotit NO2 janë regjistruar në stacionet monitoruese të vendosura në afërsi të rrugëve me trafik të dendur dhe ka një pranim universal që trajtimi i problemit të transportit është çelësi për përmisimin e cilësisë së ajrit në qytet.

Zhvillimi urban

Tradicionalisht aktivitetet ndërtimore janë kontribuesit kryesor në përqëndrimin e lartë të grimcave në ajër. Në shumë raste, zonat e banuara janë pre e pluhurit (PM₁₀ dhe PM_{2.5}) në ajër të shkaktuar nga kantieret e ndërtimit dhe të ndërhyrjeve në infrastrukturë.

Ndotja nga sektori i bujqësisë

Aktiviteti i sektorit të bujqësisë në tërësinë e tij ka ndikim direkt dhe indirekt në mjedis për shkak të shumëllojshmërisë së proceseve të punës që përfshin. Sfidat kryesore të bujqësisë janë: ngrohja globale; ndryshimet klimatike; ndërjegjësimi i fermerëve dhe këshillimi i tyre për të mirëmenaxhuar çdo proces pune.

Toka bujqësore po ndikohet nga ndryshimet klimatike. Zona është e ndjeshme ndaj permbytjeve dhe erozionit të tokës për shkak të degradimit të pyjeve në rrezedhën e sipërme dhe rënies së shpeshtë të reshjeve ekstreme.

Çdo 3 vjet, rreth 4000 m² tokë bujqësore dëmtohet për shkak të gërryrjes nga lumit Shkumbin në fshatrat Papër dhe Bradashesh përpos argjinaturave të shumta që janë ndërtuar nga Bahkia Elbasan. Ndotja nga aktivitet bujqësor ndikon negativisht në cilësinë e ajrit. Kimikatet dhe nënproduktet e agroindustrialisë janë shumë të dëmshme ndaj mjedisit natyror si dhe mund të përbëjnë probleme për njerëzit. Pesticidet e përdorura në perime e pemë frutore shkaktojnë një dëm të madh në mjedis nëse nuk përdoren në mënyrën e duhur. Gazi i Metani i ciluar nga sektori blegtorisë ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e shkarkimeve të gazeve sere në atmosferë. Shkarkimet nga përdorimi i karburanteve me cilësi të dobët nga traktoret dhe pajisjet e tjera të fermave kontribuojnë në ndotjen e ajrit.

Zjarret të cilët kohët e fundit janë bërë shqetësues për shkak të ndryshimeve klimatike si pasojë e rritjes së temperaturave të larta mund të jenë shumë të dëmshëm për mjedisin.

*Grimcat atmosferike*¹ janë ndotësit kryesorë të ndotjes së ajrit. Ato paraqiten në nivele të larta edhe pse në krahasim me vitet e mëparshme ky nivel paraqitet më i ulët falë dhe masave të cilat janë ndërmarrë, pavarësisht këtyre përqëndrimi i grimcave mbetet në nivele të larta të cilat e tejkalojnë nivelin e lejuar European.

Masat për përmisimin e cilësisë së ajrit

¹Pjesëza të imëta në trajta të ngurta ose të lëngëta të cilat ndodhen në atmosferën e tokës. Ato janë të shpërndara në atmosferën e tokës në formën e aerosoleve dhe mund të jenë natyrale sic janë stuhitë e pluhurit, zjarret në pyje, ose antropogjene të cilat janë të formuara nga aktivitetet e ndryshme industriale, djegia e lëndëve fosile në automjete apo termocentrale të cilat gjenerojnë në atmosfere sasi të konsiderueshme grimcash materiale. Grimcat me diametër më të vogël në ajër shfaqin probleme më të rënda në shëndet, pasi ato depozitohen në pjesët fundore të mushkërive dhe qëndrojnë aty për një kohë të gjatë ose depërtojnë në gjak. Grimcat e shkarkuara nga automjetet që përdorin lëndë djegëse diesel, janë vërtetuar të kenë ndikim në shtimin e mundësisë për t'u prekur nga kanceri si dhe e një sere problemesh shëndetësore serioze deri në vdekje të parakoheshme

Arritja e një përmisimi në cilësinë e ajrit në bashkinë Elbasan dhe arritja e objektivave të caktuara në lidhje me reduktimin e shkarkimeve përcaktohet nga një sërë faktorësh që varen jo vetëm nga iniciativat lokale por dhe nga politikat dhe ndërhyrjet në nivel kombëtar.

Bashkia Elbasan sipas aftësive dhe kopetencave të saj duhet të:

- Adaptojë dhe zbatojë planin e veprimit për menaxhimin e cilësisë së ajrit, për subjektet që operojnë në qytet dhe që emetojnë gazra në mjedis, bazuar në ligjet në fuqi.
- Krijimi i hapësirave të gjelbërta, duke i dhënë përparësi zonave ku ndotja paraqitet më e lartë, në sipërfaqe ende të parehabilituara.
- Krijimi i zonave me trafik të kufizuar dhe lëvizja e mjeteve të rënda për shërbimet në sektorët e ndërtimit apo tregëtisë (betoniere, eskavatorë, kamiona, etj), vetëm gjatë orëve të natës.
- Krijimi i zonës së pedalimit me bicikleta, nga stadiumi deri tek Ura e Zaranikës
- Përmirësimi i transportit publik
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore
- Matja e dendësisë së trafikut si një shkaktar kryesor të zhurmave në zonat më të populluara si dhe pranë institucioneve si shkolla, kopshte, qendra shëndetësore, qendra spitalore etj.
- Inkurajimin e përdorimit të burimeve të energjisë së ripërtëritshme ose të rinovueshme për të zëvendësuar djegien e druve, për të kënaqur nevojat energjitike për ngrohje, ftohje, ndriçim dhe prodhim të ujit të ngrohtë për ndërtesat.
- Të promovojë nisma për përdorimin e bashkëprodhimit dhe ngrohjes qendrore në mënyrë të veçantë në shëndetin publik dhe në zonat e zhvillimit të banesave të reja.
- Promovimi i zhvillimit teknologjik që ka për qëllim realizimin e sistemeve jokonvencionale/origjinale të transportit dhe prodhimin e energjisë
- Krijimi i një programi që ka për qëllim heqjen e automjeteve që ndotin shumë dhe rritjen e përdorimit të automjeteve me emetimin më të ulët.

5.Në fushën e edukimit publik

Vëmëndje kryesore duhet ti jepet informimit dhe sensibilizimit të popullatës .Suksesi i masave të këtij templati do të jetë i madh nëse popullata do të përfshihet dhe do të bëhet pjesë e problemeve të ndotjes së mjedisit .

a- Fushatave të ndërgjegjësimit dhe të sensibilizimit në mediat vizive e të shkruara, si dhe nëpërmjet materialeve informuese dhe ndërgjegjësuese si: postera, flete palosje, broshura etj., duke ftuar qytetarët që të bëhen pjesë aktive për parandalimin e ndotjeve dhe mbrojtjen e mjedisit në qytetin tonë.

- Sensibilizimit me nxënësit e shkollave për mbajtjen pastër të mjedisit ku mësojmë, me moton “Se bëshku për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm” dhe me projektet (Green School) që do zhvillohet nga ana e Inspektoriatit të Mjedisit në bashkëpunim me nxënësit e ciklit të ulët dhe të mesëm.

- Kontakte të vazhdueshme me komunitetin, veçanërisht në zonat problematike (rajoni 5 & 6) për të siguruar minimizimin e ndotjes së mjedisit si dhe implementimin e procesit të diferencimit të mbetjeve të ndarjes në burim si: Në zonën e Romëve, Krastë, lagja “skëndërbej “ etj . Për t`i bërë ato sa më atraktive dhe të mirë organizuara, të bashkëpunohet ngushtë me Administratorët e Njësisive Administrative dhe administratat përkatëse.

Vazhdimisht, inspektoriatit mjedisit.

b- Zhvillimi i aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në shkolla.

- Ngritja e rretheve të ambientalistëve të rinj, me synimin; për të ndërmarrë veprime konkrete për mbrojtjen e mjedisit dhe në fushën e sensibilizimit qytetar.

- Ngritja e këndeve të edukimit mjedisor; ku të pasqyrohen aktivitetet e kryera nga vetë shkolla, në drejtim të mbrojtjes të mjedisit.

Vazhdimisht, Mësuesit e Pedagogët e Biokimisë në arsimin 9 vjeçar, të mesëm e Universitet.

c- Në kuadrin e hartimit të buxhetimit me pjesmarrje, takimet që organizon Bashkia me komunitetin, të shërbejnë jo vetëm për një pjesmarrje sa më të madhe të tij, por edhe rritjes të ndërgjegjës e detyrimit qytetar, për të synuar qëndrime pozitive të komunitetit, në raport me elemente të veçantë të mbrojtjes së mjedisit, si:

Takime me operatorët që zhvillojnë aktivetete në zonën industriale të rrisin përgjegjësinë e tyre për minimimin e shkarkimeve në ajër.

Të grumbullimit të mbetjeve urbane në kontenierët pranë komuniteteve.

Të eliminimit të hedhjes të mbetjeve inerte në konteinerët e mbetjeve urbane.

Të hedhjes të mjeteve ndezëse në kontejneret e mbetjeve urbane.etj.

Inspektoriati Mjedisit, Njësitë Administrative, D.K.M.

d- Në bashkëpunim me O.J.F. të organizohen aktivetete në “Ditën për Qytet të Pastër” (2 Shtator). Synimi kryesor të jetë; sigurimi i kontributit të tyre në fushën e mbrojtjes të mjedisit në mjediset shkollore, universitare, në fushën e ndërtimeve, me bizneset përkatëse.

D.K.M. dhe O.J.F, Shtator 2025-2026.

e- Në bashkëpunim me O.J.F. të bashkëpunohet për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë dhe mundësinë e ndarjes të mbetjeve urbane të riciklueshme në kontejnerët përkatës, sipas programit Kombëtar të miratuar të Qeverisë.

D.K.M.. dhe O.J.F.

f- Të propogandohet vazhdimisht, nëpërmjet mediave vizive dhe të shkruara, problemet e ndryshme në fushën e mbrojtjes dhe të ruajtjes të mjedisit.

Vazhdimisht Bashkia.

6.MASAT PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SHKARKIMET INDUSTRIALE

1- Në bashkëpunim me Agjensinë Rajonale të Mjedisit, Prefektit, deri tek AKM, të sensibilizohet në mënyrë të vazhdueshme ndaj operatorëve të mëdhenj industriale si: “Kurum International”, “Albchrom”, “CCALB”, “RBH BELINE”, “Impuls Industri”, “G.S.A” etj.; me objektivin që ato të respektojnë detyrimisht normat e miratuara të shkarkimeve në ajër, si bazë kjo për të arritur në një kohë sa më të afërt, normat e vendosura nga KE., si pjesë e plotësimit të standarteve të vendosura prej saj.

Po në këtë kontekst, të merren masa parandaluese teknike, duke vërejtur se niveli i ndotjes mjedisit për shkak të shkarkimeve të pakontrolluara është ende në nivele të larta.

Vazhdimisht, ARM,AKM,Inspektoriati Mjedisit,

2- Përgatitja e një inventari vendor me shkarkimet nga të gjitha subjektet e regjistruara në bashkinë Elbasan dhe që raportojnë pranë agjensisë kombëtare të mjedisit për të bërë të mundur kryerjen e vlerësimeve për shkarkimet ndotëse në bashki, veçanërisht mbi përdorimin e tyre të energjisë dhe llojin e lëndës djegëse që përdorin.

Vazhdimisht, Inspektorët e Monitorimit të Ajrit, Inspektoriati Mjedisit.

3- Të bashkëpunohet me ARM, në lidhje me monitorimin e treguesve të cilësisë t1% ajrit urban, veçanërisht për përmbajtjen e lëndëve pezull në ajër, si dhe të përmbajtjes së SO₂, BTX, NO_x, O₃, CO, etj si komponentë të dëmshëm në ajër dhe në organizmin e njeriut. Njëkohësisht të kërkohej informacion i vazhdueshëm mbi nivelet e këtyre komponentëve për pikën e matjes në qytet (pranë prefekturës)

Vazhdimisht, A.K.M, Inspektoriati Mjedisit.

4- Të vazhdojë puna për evidentimin dhe matjen e nivelit të ndotjes së ajrit për subjektet që operojnë në qytet dhe që emetojnë gazra në mjedis, veçanërisht për furrat që punojnë me lëndë djegëse të llojeve të ndryshme. Për këtë të zbatohet skema e kontrollit sipas ligjit përkatës:

a. Instalimin e sistemit të aspirimit.

b. Matjet e nivelit të ndotjes nga gazrat.

Inspektoriati i Mjedisit.

7.PASTRIMI I QYTETIT DHE NJESIVE ADMINISTRATIVE NGA MBETJET URBANE.

1- Sektori i mjedisit në bashkëpunim me sektorët e tjerë përgjegjës në Bashki, të hartojnë në kontratën e ardhshme për pastrimin e qytetit indikatorë cilësorë dhe sasiorë të cilët duhet të rrisin në shkallë më të lartë dhe efektivitet ekonomik, rritjen e cilësisë të shërbimit dhe të mjedisit në qytet e në fshat, me synim; rritjes të cilësisë së jetës të të gjithë komunitetit të Bashkisë Elbasan e me gjërë. Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet:

- Rritjes të frekuencës së larjes të rrugëve me intensitet të lartë qarkullimi, nga 120 ditë në 180 ditë, sipas një kalendari të përcaktuar e veçanërisht për stinën e verës, për të krijuar një mikroklimë sa më të përshtatshme në qytet.

- Rritjes së sipërfaqes të pastrimit të rrugëve dytësore, si rezultat i realizimit të investimeve që do të kryhen në vazhdim, në infrastrukturë.

- Largimi në kohë e me cilësi, i mbetjeve urbane nga pikat e grumbullimit sipas grafikëve të hartuar e dërgimin e tyre në lëndfill-in e ri të mbetjeve.

-Pastrimit, dizinfektimit çdo ditë të kontejnerëve, si dhe sipërfaqeve rreth vendqëndrimit të tyre në përputhje me detyrimet kontraktore.

Sipërmarrësi Pastrimit, D.SH.T.U në Bashki

2- Plotësimit me kosha rrugorë (në vende ku mungojnë apo duhen shtuar) për garantimin e pastërtisë në hapësirat publike, për të minimizuar dhe mbajtur sa më pastër hapësirat nga mbetjet urbane të dimensioneve të reduktuara e të prodhuara nga qytetarët. Për arritjen e këtij objekti të hartohen fish projektet përkatëse për të gjetur donatore vendas apo të huaj.

D.K.M, A.SH.P të Bashkisë.

3- Të merren masa sigurie sa më të larta të jetë e mundur, për kontrollin teknik sipas kërkesave të kontratës, e njëkohësisht për propogandimin në publik, për evitimin e rënies së zjarreve në vendgrumbullimin e mbetjeve urbane.

Vazhdimisht Sipërmarrësi i pastrimit, Bashkia.

4- Per evitimin e djegjes të mbetjeve urbane brenda kontejnerëve, të kërkohet ndihmesa e qytetarëve, si mase e efektshme për parandalimin e ndotjes së ajrit, pra dhe të pakësimit të rrezikut mjedisor e shëndetësor nga komponentët e dëmshëm nga djegja.

Vazhdimisht sipërmarrësi i pastrimit, Bashkia.

5- Nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme, t'i kërkohet çdo subjekti tregtar që është e detyrueshme në mënyrë konstante, të mbajë pastër mjedisin përreth, trotuarin, kuletën dhe për rrjedhojë, mos zbatimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe i vendimeve të Këshillit Bashkiak është i ndëshkueshëm.

Vazhdimisht, subjektet private, Bashkia

6- Në zbatim të ligjit e të parimit “Ndotësi paguan”, Policia Bashkiake dhe Inspektoriati Mjedisit i Bashkisë të rrisë shkallën e kontrollit të zbatimit të ligjit, duke bashkëpunuar edhe me sektorët përkatës.

Vazhdimisht, Inspektoriati Mjedisit i Bashkisë.

7- Për ndërtimet e reja, projektet e rikonstruksioneve apo zonat e reja urbane, është i detyrueshëm, në bazë të kuadrit ligjor ekzistues; bashkë me dhënien e lejes së ndërtimit të përcaktohen dhe vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane për vendosjen e kontejnerëve.

Subjektet private të ndërtimit, Drejtoria e Urbanistikës.

8- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në 4 Njësitë Administrative që nuk kryhet shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane:

- Njësia Administrative Gracen;
- Njësia Administrative Funar;
- Njësia Administrative Labinot-Mal;
- Njësia Administrative Zavalin.

Bashkia.

9- Rehabilitimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane dhe inerteve që janë mbyllur, për t'u plotësuar me kushtet dhe kriteret e ligjit për funksionimin e tyre në zonat:

- Njësia Administrative Shirgjan (kanali me kamba);
- Njësia Administrative Gjergjan;
- Njësia Administrative Papër;
- Njësia Administrative Bradashesh (Ura Kushës – përroi fshati Letan).

Bashkia.

8- Sigurimi i projekteve që paraqiten nga donatore, investitore të huaj apo vendas dhe që përputhen me prioritetet në planin vendor të mjedisit dhe me strategjinë e hartuar nga Bashkia enkas për trajtimin e mbetjeve urbane, e që çojnë në minimizimin e ndotjes në përputhje me standartet e miratuara nga K.E.

Vazhdimisht, Bashkia.

9- Për t'i paraprirë procesit të trajtimit të integruar të mbetjeve urbane për qytetin, në përputhje edhe me strategjinë e hartuar, të llogariten nevojat konkrete për sasinë dhe tipin e kontenierëve, duke përfshirë edhe nevojat investuese, nëse është e mundshme, për realizimin e programit vendor dhe shtetëror. Për këtë problem të hartohen projektet përkatëse.

Bashkia.

8.PERMIRESIMIN E MJEDISIT TE GJELBERT NE QYTET DHE NE ZONAT RURALE PER PERMIRESIMIN E CILESISE SE JETES TE QYTETAREVE.

1-Nëpërmjet kryerjes në kohë e me cilësi, të shërbimeve në sipërfaqet e gjelbërta publike, sipas buxhetit të miratuar të Bashkisë, të sigurohet në vazhdimësi një mjedis i pastër, çlodhës e argëtues për qytetarët.

Bashkia,Inspektoriati Mjedisit.

2- Në përputhje me planin rregullues të qytetit, për vitin 2025-2026:

- Investime në lulishte sipas programit përkatës në qytet.

Bashkia Elbasan.

3- Vazhdimi i përmirësimit të kushteve sociale të akomodimit në kopshte, nëpërmjet instalimit të sistemit të ngrohjes, në bashkërendim edhe me kërkesat mjedisore të projektit ENSI.

Q.E.A.

4- Në përputhje me planin strategjik të Bashkisë, të kryhen rikostruksionet e objekteve arsimore sipas planit të investimeve të miratuar për vitet 2025-2026, duke përmirësuar kushtet sociale e mjedisore të tyre.

Q.E.A.

5- Vazhdimi i investimeve në sistemin e ndriçimit rrugor të qytetit duke përdorur ndriçues luminishent ekonomik, sipas kërkesave të standarteve të B.E.

A.SH.P.,

Bashkia.

6- Plotësimi aty ku duhet me pemë dekorative e shkurre, dhe kryerja në kohë e me cilësi e shërbimeve agroteknike në parkun "Rinia", në mjediset e "Krastes" dhe në brigjet e lumit Shkumbin me synim krijimin e një mjedisi çlodhës e argëtues në rritje të kënaqësisë qytetare.

Bashkia.

7-Të vazhdojë mbjellja e pemëve në hapësirat e gjelbra të qytetit (pëmendim këtu mbjelljen e pemëve të reja në kuadër të javës së pyllëzimit në bashkëpunim edhe me shoqatën Tjeter Vizion).

Bashkisë Elbasan, Shoqata të ndryshme.

8- Vazhdim i Ndërtimit të Murit të Gjelbër në zonën e ish-Kombinatit Metalurgjik.

Në bashkëpunim me Bizneset e Zonës dhe më gjërë.

9- Të vazhdojë krijimi i lulishteve të reja në qytet. Plotësimi aty ku duhet me pemë dekorative i rrugëve kryesore dhe të Njësive Administrative të Bashkisë.

Bashkia Elbasan

10- Mirëmbajtja e Parkut Rinia me të gjithë elementët funksionale të tij zëvendësimi i pemëve të dëmtuara.

Bashkia Elbasan

11- Të hartohen Planet e menaxhimit të pyjeve në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi

Bashkia Elbasan.

12- Sistemimi, asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugëve parësore e dytësore të Bashkisë, sipas buxhetit të detajuar e miratuar për vitin 2025-2026 të Bashkisë, si bazë e rëndësishme për uljen e ndotjes ajrit dhe rritjen e cilësisë së jetës në qytet.

Bashkia Elbasan.

9.FURNIZIMI ME UJE TE PIJSHEM.

1-Ndjekja në vazhdimësi, e plotësimit në sasi e cilësi të nevojave për ujë të pijshëm të popullatës në qytet e fshat, vënia në zbatim e projektit të shtrirjes së tubacioneve të reja për paisjen me ujë 24h pa ndërprerje. Kontrolli sistematik i kryerjes së analizave bakteriologjike e kimike të ujit të pijshëm nga "Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Elbasan" dhe nga Inspektoriati Higjieno sanitar i D.SH.Publik të qarkut.

Vazhdimisht "Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Elbasan", I.SH.SH.

2-Ndjekja në vazhdimësi, e plotësimit në sasi e cilësi të nevojave për ujë të pijshëm të komunitetit të fshatrave, të Njësive Administrative. Kontrolli sistematik i kryerjes të analizave bakteriologjike e kimike të ujit të pijshëm nga Inspektoriati Higjieno sanitar i I.SH.SH.Publik të Qarkut.

Vazhdimisht "Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Elbasan", I.SH.SH., Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan.

3- Eliminimi në kohë i defekteve të çarjes të tubacioneve, si burim ndotës i ujit të pijshëm për qytetin e fshatin.

Vazhdimisht "Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Elbasan", D.SH.T.U.

Njadm. Administrative.

4- Vazhdimi i monitorimit të harxhimit të ujit të pijshëm nga popullata, me anë të matësve të ujit dhe kompletimi me aparatura komanduese, veçanërisht në zonat periferike të qytetit, si masë e domosdoshme për mire administrimin e ujit.

Vazhdimisht "Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Elbasan".

5- Respektimi i masave higjieno sanitare në depot e ujit të pijshëm, mbrojtja nga depërtimi i ujrave sipërfaqësore, plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga administrimi i puseve dhe depove të ujit, si dhe të zonave të mbrojtjes sanitare.

Vazhdimisht "Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Elbasan".

6- Sensibilizimi i Institucioneve përgjegjëse e kompetente zyrtare, për mbrojtjen e basenit ujqor të Shkumbinit nga infiltrimi i ujrave të ndotura të lumit, në basenet ujore ku furnizohet qyteti me ujë të pijshëm.

Bashkia Elbasan.

7- Të hartohen miniprojekte, për kursimin e ujit të pijshëm në sektorët e shërbimit ndaj publikut, duke i zëvendësuar ato me ujë jo të pijshëm.

Bashkia Elbasan.

10. PROBLEME TË SISTEMIT TË KANALIZIMEVE TË UJRAVE TË ZEËA DHE TË BARDHA

1-Mirëmbajtja e rrjetit të KUZ, KUB dhe dezinfektimi i pusetave si dhe i sipërfaqes përreth.

Vazhdimisht "Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Elbasan" dhe A.SH.P e

Bashkisë

2- Të kryhet në vazhdimësi zhblllokimi dhe pastrimi i pusetave të rrugëve dhe rrjetit të kanaleve të kullimit të ujrave. Pastrimi i pusetave të bëhet para sezonit të shirave dhe bashkë me të, edhe dezinfektimi rreth tyre me dezinfektant kimik.

Vazhdimisht A.SH.P

3- Duke pasur parasysh të dhënat e analizave bakteriologjike dhe kimike të I.SH.SH, për lumin e Shkumbinit, të cilat tregojnë ndotjen e lartë të tij si rezultat i mungesës të përpunimit të ujrave të zeza gjatë gjithë rrjedhës së tij; të sensibilizohen institucionet kompetente, që të parashikohen sa më shpejt të jetë e mundur fonde me qëllimin final, ngritjen e impianteve të përpunimit të ujrave të zeza.

Bashkia Elbasan

11. NDOTJA AKUSTIKE.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të ndotjes akustike në qytet, konform me ligjet dhe udhëzimet në fuqi, do të parashikohen masat e mëposhtme:

1- Bashkëpunimi me drejtoritë dhe institucionet e tjera përgjegjëse, si dhe me komunitetin për evidentimin dhe më pas trajtimin sipas ligjit, të problemeve që lidhen me ndotjen akustike në qytet.

Inspektoriati i Mjedisit, I.SH.SH. Policia Bashkiake.Policia Shtetit.

2- Të vazhdojë kontrolli sidomos në sezonin e verës, për zbatimin e ligjit përkatës për çdo subjekt që emeton zhurma në mjedis, e veçanërisht në qendra të banuara dhe kur është e nevojshme të kërkohet të kryhen matjet për nivelin e ndotjes akustike nga institucionet përkatëse.

D.R.M, D.SH.P, I.SH.SH.

3- Të bashkëpunohet me D.R.T.SH dhe me subjektin përkatës, për mundësinë e matjes dhe respektimit të kërkesave për nivelin e zhurmës që emetojnë mjetet e lëvizshme të transportit rrugor.

D.R.M e Qarkut.

4- Pajisja e subjekteve me leje ushtrimi aktiviteti 24 orë të bëhet në zbatim të ligjit Nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”, duke përcaktuar rregulla të qarta për distancën nga banesat, sistemin akustik të brendshëm, dhe konsultim të vazhdueshëm me Policinë e Shtetit.

Bashkia gjatë vitit 2025-2026.

- 5- Të ushtrohen kontrole për zbatimin e dispozitave ligjore për burimet e zhurmave në mjedise , e mbi bazën e niveleve kufi për qendrat urbane, të merren masa sipas ligjit për kundërvajtësit.

D.SH.P, I.SH.SH D.R.M , Inspektoriati Mjedisit.

- 6- Në kuadër të miratimit të planit kombëtar për zhurmat, do të vazhdojnë aksionet e përvitshme për identifikimin dhe eliminimin e ndotjeve akustike, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Institutin e Shëndetit Shëndetsore dhe Policinë Bashkiake.

Inspektoriati i Mjedisit, Policia Bashkiake, ISHSH

- 7- Vendosja e sinjalistikës vertikale për ndalimin e përdorimit të borive të makinave në rrugët pranë institucioneve sensible si dhe institucione arsimore, shëndetësore, gjyqësore dhe administrative në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

Spektori i Transportit

12. PROBLEME TE TRANSPORTIT DHE LEVIZSHMERISE.

Përmisimi i infrastrukturës së lëvizjes për të mbështetur lëvizshmërinë efektive, ndërlidhjen më të mirë dhe reduktimin e bllokimeve të trafikut në bashkinë tonë, ndërhyrjet konsistojnë në :lidhjen ndërmjet qendrave kryesore urbane me qytetin e elbasanit, ndërtimi i bajpasit të qytetit për të reduktuar trafikun ndërqytetas si dhe përmisimi i transportit publik nëpërmjet ndërhyrjeve në internëret në stacionet e autobusave/fugonave dhe mjeteve të tjera, rrregullimi i trafikut duke rehabilituar rreth rrotullimet, kryqëzimet kryesore në qytet dhe promovimi e investimeve publike e private në fushën e lëvizshmërisë së gjelbër për këmbësorët (bicikleta, rrugët natyrore dhe recreative).

1- Monitorimi i ndotjes së ajrit në qytet nga gazrat, duke përfshirë edhe automjetet, për: PL. total, PM10, B.T.X., NOx, SO2, CO, CO2, etj (nga paisjet dixhitale të monitorimit të ajrit).

Nëpërmjet marrjes të informacioneve për monitorimin e gazrave dhe pluhurave, të arrihet një nivel më i lartë i mbrojtjes të mjedisit.

Vazhdimisht A.R.M. Inspektorët e Mjedisit.

2.Krijimi i mundësive alternative të lëvizjeve së mjeteve veçanërisht në rrugët ku fluksi i lëvizjes apo qëndrimit të qytetarëve është më i madh, për të pasur një cilësi të ajrit më të lartë.

D.SH.T.U, Policia Bashkiake. Inspektoriati i mjedisit

3- Për disiplinimin e lëvizjes të automjeteve të vendosen (aty ku mungojnë), "policë të shtrirë rrugor", sipas planit të miratuar të investimeve.

A.SH.P. Bashkia. D.SH.T.U.

4- Vazhdimisht të plotësohet sinjalistika vertikale, në përputhje me makroskemën e lëvizjes së mjeteve në qytet, për të rritur sigurinë rrugore të qytetarëve, rrjedhshmërine e qarkullimit etj.

A.SH.P., D.SH.T.U.

5-Ndalimi i qarkullimit të mjeteve të rënda në rrugët e brendshme të qytetit gjatë orareve të ditës nga ora 07 e mëngjesit deri në orën 17 të mbrëmjes gjatë periudhës së dimrit dhe nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 19 gjatë periudhës së verës.

6.Kufizimet për automjetet më ndotëse në qendrat urbane të njësive bashkiake, gjatë ditëve të javës (kufizimet mbulojnë automjetet e klasifikuar euro1 dhe euro 2)

7.Përtëritja e flotës së automjeteve të përdorura nga organet publike, koncesionarët e shërbimeve publike dhe kompanive komunale/shërbimeve (operatorët e transportit, grumbullimit të mbeturinave; pastrimit të rrugëve, operatorët e rrjetit të energjisë, burimeve ujore, autobusa shkolla) me automjete me ndikim të ulët /zero në mjedis.

8.Promovimi i parkimeve të kufizuara në qendër të bashkisë për të reduktuar ngjeshjen e shkaktuar nga automjetet private dhe shkarkimet e automjeteve. Masat e propozuara mund të përfshijnë ngritjen e tarifës së parkimit në rrugë, zbatimin e rregulloreve në parkimet e kufizyara në zona larg qendrës së bashkisë dhe dekujarimi i parkimit në rrugë gjatë gjithë ditës.

Drejtoria e politikave të shërbimit urban, policia bashkiake njësitë administrative

13. PER PARANDALIMIN E SITUATAVE EMERGJENTE NATYRORE DHE SEMUNDJET EPIDEMIKE E INFEKTIVE.

1- Për mbrojtjen e qytetit nga vërshimi i ujrave me llumra, në sezonin apo ditët me reshje të larta, të mbahet në kushte normale shfrytëzimi i kanalit të ujrave të larta dhe kanali i ujrave sekondare në pjesën veriore të qytetit. Një kujdes i veçantë të tregohet në lidhje me mbikqyrjen e rezervuarëve të ujit dhe kontrollin e herpashershëm të argjaturës së tyre, si dhe kujdesin për funksionimin normalisht të kanaleve kullues nëpër fshatrat e Njësive Administrative, me qëllim parandalimin e përmytjeve të mundshme.

Vazhdimisht A.SH.P., Njësia Administrative, Emergjencat Civile

2- Për të reduktuar në maksimum ndotjen e përroit të Manazderes nga hedhjet e pakontrolluara të mbetjeve urbane, të parashikohen fonde për pastrimin e herpashershëm të shtratit dhe shpatullave të tij.

Bashkia Elbasan

3- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe nga informacionet nga qytetarët, të ushtrohen kontrole të përbashkëta, për marrjen e masave parandaluese për evitimin e shfaqjeve të sëmundjeve infektive dhe të epidemive në qytet, e sidomos në zonat periferike me infrastrukturë ende të pa kompletuar mirë.

Gjate vitit D.SH.P., Bashkia.

4- Për të shmangur mundësinë e lindjes të epidemive apo të sëmundjeve infektive, mbi bazën e evidentimit në terren të problemeve që lidhen me garantimin e shëndetit publik të qytetarëve, të parashikohen fonde për kryerjen e punimeve në bodrumet poshtë pallateve, si qendra më të mundshme infeksioni apo epidemie.

A.SH.P. Bashkia, Zjarrfikse, Emergjencat Civile

14. MBI INSPEKTORIATIN DHE SHERBIMIN VETERINAR.

Spektori i shërbimit veterinar, në rang inspektoriatit të vazhdojë mbulimin me shërbim veterinar dhe të ushqimit të të gjitha subjekteve që prodhojnë, tregtojnë, importojnë, magazinojnë produkte dhe n/produkte e që operojnë në qytet e në fshat. Garantimi teknik i produkteve ushqimore, për të rritur sigurinë ushqimore, zbatimi i Direktivave të Komunitetit Europian. Për këtë qëllim të zbatohen masat e mëposhtme:

1- Therja e kontrolluar e bagëtive të destinuara për tregëtimin e mishit të freskët. Lejimi i mishit për konsum, të kryhet vetëm me çertifikate veterinarë.

Spektori Veterinar i Bashkisë, në bashkëpunim me A.K.U

2- Të ushtrohen kontrole teknike për respektimin e parametrave higjieno sanitare, analizave bakteriologjike, fiziko-kimike për produktet e gatshme, në të gjithë stabilimentet e prodhimit e përpunimit të produkteve shtazore.

Spektori Veterinar i Bashkisë, në bashkëpunim me A.K.U

3- Të bashkëpunohet me A.K.U e qarkut, për kontrollin cilësor, afatet e skadencave etj., të produkteve ushqimore në qytet.

Sektori i Mbrojtjes Konsumatorit , A.K.U.

4- Të ushtrohen kontrole të herëpashershme për respektimin e kërkesave ligjore mjedisore, për shkarkimet e mbetjeve nga thertoret dhe stabilimentet e përpunimit të produkteve shtazore, duke i kërkuar subjekteve, lejet mjedisore përkatëse.

Sektori i mbrotjes së konsumatorit , inspektoriati mjedisit.

5- Të bashkëpunohet me A.K.U, për zbatimin e kalendarit veterinar për zonën s/urbane.

A.K.U. sektori veterinar.

6- Në bashkëpunim me A.K.U., D.SH.P., të ushtrohen kontrole për të mos lejuar asnjë rast të antropozoonozë, apo toxiifeksioni alimentar, ngë përdorimi i ushqimeve me origjine shtazore.

Inspektoriati veterinar, A.K.U., D.SH.P.

7- Të ushtrohen kontrole në Q.E.A. si dhe Q.S.B., për cilësinë dhe llojet e racioneve ushqimore që përdoren, për të përmbushur standartet në ushqyerjen e fëmijëve në çerdhe e kopshte.

Sektori i Mbrojtjes Konsumatorit, Inspektoriati i Bashkisë.

8- Të ndiqet zbatimi i kalendarit përkatës, për trajtimin e qenve rrugaçe (sipas ligjit për këtë qëllim)

Bashkia.

15. MBI INSPEKTORIATIN E MJEDISIT.

1- Subjektet private të ndërtimit që kryejnë punime investimesh në territorin që mbulon Bashkia; të mbajnë të pastra mjediset publike nga mbetjet inerte, dherat apo materialet e tjera të ndërtimit duke i evaduar ato në vendet përcaktuara

Vazhdimisht, subjektet private të ndërtimit, Inspektoriati Bashkiak

2- Personat fizike e juridike, veprimtaria e të cilëve krijojnë mbetje, detyrohen të hartojnë programin e masave teknike - teknologjike e organizative të trajtimit të mbetjeve, i cili kontrollohet nga inspektoriati i mjedisit, inspektoriati sanitar dhe inspektoriati i bashkisë.

Vazhdimisht, Subjektet private.

3- Inspektime të vazhdueshme të qendrës spitalore dhe qendrave ambulatore për diferencimin e mbetjeve spitalore dhe evadimin e tyre sipas ligjit në fuqi dhe kontratave të nënshkruara me subjektet përkatëse për asgjësimin e tyre.

Inspektoriati i Mjedisit.

4- Ndjekja për pastrimin dhe vlerësimin e mbetjeve inerte dhe të përziera, si dhe zbatimi i kërkesave ligjore për depozitimin e tyre në vendin e përcaktuar.

A.SH.P, Inspektoriati Mjedisit i Bashkisë.

5- Identifikimi dhe detyrimi ligjor i subjekteve që hedhin mbetje inerte e të vëllimshme në hapësirat publike.

Njësitë Administrative, Inspektoriati Mjedisit i Bashkisë.

6 Në bashkëpunim me inspektoriatin e mjedisit, inspektoriatin sanitar, UKE të ushtrojnë kontrolle për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngta, ujrave të ndotura sipërfaqësore në zonat urbane, e sidomos ato periferike.

A.R.M. Inspektoriati Mjedisit.

10- Të ushtrohen kontrole për pastrimin e hapësirave publike, terreneve private, të hapësirave për rreth lokaleve dhe pikave të shitjes me shumicë, pakicë e ambulate, në pikat me aktivitet ngarkim-shkarkimi etj. dhe për kundravajtësit të zbatohen sanksionet ligjore.

Policia Bashkiake, Inspektoriat Mjedisit.

11- Të ushtrohen kontrole në respektimin e distancave të parkimit, të mjeteve pranë kontejnerëve të mbetjeve urbane.

Supervizorin e pastrimit.

12- Të ushtrohen kontrole, duke bashkëpunuar me supervizorin e pastrimit, subjektin e pastrimit, për zbatimin e rregullave dhe detyrave kontraktore, me qëllimin ; mbajtjen e qytetit sa më të pastër.

Sipërmarrësi i pastrimit, D.K.M.

16.PROMOVIMI I TURIZMIT

Turizmi mbetet një potencial i pa shfrytëzuar për bashkinë. Elbasan 72% e territorit të bashkisë është hapësirë natyrore e paprekur nga aktiviteti njerëzor me potencial të madh për zhvillimin e turizmit aventuresk (kodrinor/malor) fshatrat në skajet e bashkisë janë shumë panoramike dhe kanë potencial për oferta të ndryshme turistike përfshirë ecjen, ecjen me bicikletë në mal hedhjen me parashutë, sporte ajore. Turizmi kulturor është i pranishëm çdo ditë dhe zhvillohet rreth monumenteve kulturore që përfaqësojnë të kaluarën bizantine dhe osmane të qytetit. Në bashkinë elbasan 18 monumënte kulture, janë në rishikim ku përfshihen urat, xhamite, kishat, bazilikat, hamami i kalasë, shtëpitë, dy shtëpitë muze, Kalaja e Skampit dhe stacioni Ad Quintum (në Egnatia) etj

Turizmi i banjave termale i cili zhvillohet në Njadm Tregan, është aktiviteti kryesor turistik i cili mbulon rreth 70% të ofertës turistike të bashkisë. Numri i vizitorëve në sezionin e fluksit (prill-qershor dhe shtator-nëntor) arrin në 4000 në ditë, ku (10% janë shqiptarë dhe pjesa tjetër nga Kosova, Maqedonia e Veriut).

Si masa për rritjen e cilësisë së jetës, në drejtim të zhvillimit të turizmit si pjesë e strategjisë së zhvillimit të qytetit pra dhe të mjedisit komunitar, të parashikohen dhe zbatohen sipas planit të miratuar të investimeve këto masa:

1- Pasurimi vazhdimisht i Enciklopedisë së Elbasanit, për të rritur shkallën e njohjes së vlerave dhe traditave të qytetit tonë.

Bashkia Elbasan, grupi i punës.

2- Vazhdimi i kompletimit me pajisje i qendrave muzeale e historike të qytetit (bibliotekës, muzeut, etj.), sipas planit të miratuar në Këshillin Bashkiak.

Bashkia Elbasan

3- Zyra e informacionit turistik, të rrisë në shkallë më të lartë, promovimin e vlerave turistike të qytetit nëpërmjet guidave, informacioneve me vlera historike, arkeologjike, arsimore, etj.

Z.I.T. Bashkia Elbasan.

Konceptoi:

- I. Dybeli. (Përgjegjësi Grupit të Punës).
- R. Nishku. Inspektoriati Mjedisit.
- I. Baho. Sektori i Bujqësisë.
- J. Bodurri. Drejtorja e Pyjeve.
- A. Peçi. Drejtorja e Urbanistikës.
- Z. Broshka. Drejtorja e Koordinimit dhe Monitorimit.
- A. Hazizolli. Drejtori i Mjedisit
- Sh. Çullhaj. Drejtori i Përgjithshëm

KRYETARI
Gledian Llatja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E PYJEVE, BUJQËSISË DHE MJEDISIT
DREJTORIA E MJEDISIT BUJQËSISË DHE VETERINARISË
INSPEKTORATI I MJEDISIT

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ .2024

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë: ____ . ____ .2024

“Për miratimin e Planit Vendor të Mbrojtjes së Mjedisit 2025 – 2026 “ .

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr 9974 date 12.07.2007 “ Për vleresimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis“ si dhe Urdhërit Nr 4001 datë 29.08.2024 i Kryetarit të Bashkisë “ Për Ngritjen e grupi të punës për hartimin e planit vendor të mjedisit për periudhen 2025 – 2026”.

VENDOSI:

1. Të miratoje Planit Vendor të Mbrojtjes së Mjedisit 2025 – 2026 “ .
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Inspektoriati Mjedisit të Bashkisë
3Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas percaktimeve te nenit 55, pika 6 e Ligjit Nr 139/2015 “ .

Konceptoi: Përgj. Sektori I .Dybeli

Pranoi: Drejtori Mjedist. E. Hazizolli

Konfirmoi Juristi . K.Totoshi

Miratoi: Dr. Përgjithshëm.Sh.Çullhaj

SEKRETARI

Elvi Çuni

KRYETARI

Lufi Lala



6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PERGJITHSHME E POLITIKAVE TE ZHVILLIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 5879 Prot.

Elbasan më 12. 2024

RELACION
Për Propozimin e Krijimit të bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Komunës së Preshevës, Serbi

KËSHILLIT BASHKIAK
ELBASAN

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Ju informojme se institucioni ynë, Bashkia Elbasan, synon vendosjen e urave të bashkëpunimit me Komunën e Preshevës mbështetur kjo edhe në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ligjit nr. 43/2016 “Për Marrëveshjen Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është të sigurojë një mënyrë bashkëveprimi dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis Palëve, në promovimin dhe zhvillimin e kulturës si dhe trashëgimisë kulturore midis këtyre dy qyteteve si fusha me interes të përbashkët midis këtyre dy qyteteve potenciale.

Fushat e Bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme të veprimit:

1. Në fushën e Trashëgimisë Kulturore nëpërmjet;

- ✓ fuqizimin e partneriteteve midis dy qyteteve
- ✓ ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta që synojnë shkëmbimin e praktikave të sukseshme.
- ✓ shkëmbimin e përvojave në zhvillimin e aktiviteteve të turizmit malor dhe promovimin e qyteteve turistike në të dy njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke organizuar promovimin e përbashkët të eventeve turistike;
- ✓ aktivitete të përbashkëta kulturore dhe projekte të përbashkëta duke synuar promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit të Elbasanit dhe të qytetit të Preshevës.

2. Në fushën e Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet:

- ✓ promovimit të produkteve dhe shërbimeve rajonale të prodhuara nga sektorët potencial të zhvillimit në të dy njësitë e vetëqeverisjes vendore;

3. Në fushën e Arsimit nëpërmjet:

- ✓ bashkëpunimit në arsimin parauniversitar, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira mes shkollave, si dhe organizimin e aktiviteteve arsimore dhe edukative;

4. Në fushën e Sportit nëpërmjet:

- ✓ zhvillimit të aktiviteteve sportive të përbashkëta, organizimin e kampionateve ndërqytetare dhe nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive.

Sa më sipër kërkojmë nga Ju miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Komunës së Preshevës.

Duke ju falenderuar!

Konceptoi: P.S.A.P
P.P.D

E. Stafa
K.Kreka

Pranoi: D.P.K.S.A.P.R
D.P.P.ZH


D. Roseni
S.Mehmeti

Miratoi: Shefi Kabinetit E.Muço

ZV/KRYETARI

Asim SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Elbasan



REPUBLIKA E SËRBIË

Komuna Preshevë

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

NDËRMJET

KOMUNËS PRESHEVË

DHE

BASHKISË ELBASAN

Elbasan, Dhjetor 2024

**MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
NDËRMJET
KOMUNËS PRESHEVË
DHE
BASHKISË ELBASAN**

Ky Memorandum Mirëkuptimi ("MM") nënshkruhet ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Komunës Preshevë, me qëllimin e rritjes së urave lidhëse të bashkëpunimit midis dy qyteteve. Nëpërmjet këtij memorandumi bashkëpunimi midis Bashkisë Elbasan dhe Komunës Preshevë synojmë të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, arsimin, edukimin, sportin, trashëgiminë historike dhe shkëmbimin kulturor, burimet natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor midis dy qyteteve.

Duke patur parasysh, fuqizimin dhe bashkëpunimin e qëndrueshëm midis këtyre dy qyteteve synojmë të promovojmë zhvillimin e qëndrueshëm, barazinë gjinore, qeverisjen e mirë dhe promovimin e vlerave historike dhe kulturore.

Duke patur parasysh, se Bashkia Elbasan është e interesuar në përmirësimin e kushteve të jetës së qytetarëve të vet, përmes cilësisë më të mirë të ofrimit të shërbimeve, rritjes së demokracisë vendore, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies ndaj grupeve të ndryshme të interesit publik, ngritjes së partneriteteve me aktorë social dhe ekonomik, kërkojmë të nënshkruajmë këtë marrëveshje ndërinstitucionale, e cila jo vetëm do të promovojë vlerat historiko-kulturore, të trashëgimisë, arsimin, sportin, kulinarisë, veshjeve tradicionale të qytetit e më gjerë, por ndërkohë do të mundësojë edhe fuqizimin ekonomik e social të këtyre dy qyteteve partnere.

Duke patur parasysh, se Palët ndajnë misionet të ngjashme dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë në fusha me interes të përbashkët për të rritur efektivitetin e përpjekjeve të tyre për zhvillim;

Kështu që, Palët shprehin synimin e tyre për të bashkëpunuar si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Memorandumi është të sigurojë një mënyrë bashkëveprimi dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis Palëve, në promovimin dhe zhvillimin e e qëndrueshëm ekonomik, trashëgiminë historike dhe shkëmbimin kulturor, burimet natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, si fusha me interes të përbashkët midis dy qyteteve.

Neni 2

Fushat e Bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme të veprimit:

- (i) Fuqizimi i partneriteteve midis dy qyteteve në fushën e trashëgimisë kulturore;

- (ii) Ofrimi i shërbimeve dhe aktivitetëve të përbashkëta që synojnë shkëmbimin e praktikave të sukseshme në fushën e trashëgimisë kulturore;
- (iii) Promovimin e produkteve dhe shërbimeve rajonale të prodhuara nga ndërmarrjet në të dy njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- (iv) Shkëmbimin e përvojave në zhvillimin e aktivitetëve të turizmit malor dhe promovimin e qyteteve turistike në të dy njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke organizuar promovimin e përbashkët të eventeve turistike;
- (v) Aktivitete të përbashkëta kulturore dhe projekte të përbashkëta duke synuar promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit të Elbasanit dhe të qytetit të Preshevës.
- (vi) Bashkëpunimin në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira mes shkollave, si dhe organizimin e aktivitetëve arsimore dhe edukative;
- (vii) Bashkëpunimin në fushën e sportit, duke përfshirë zhvillimin e aktivitetëve sportive të përbashkëta, organizimin e kampionateve ndërqytetare dhe nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive.

Neni 3

Konsultimi dhe Shkëmbimi i Informacionit

- 3.1 Palët, të mbështetura në parimet bazë, do të mbajnë të informuar njëra-tjetrën dhe do të konsultohen për çështjet me interes të përbashkët, të cilat synojnë të çojnë në bashkëpunim të ndërsjelltë.
- 3.2 Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumentave midis këtyre dy qyteteve potenciale do të realizohet duke u mbështetur në aktivitetet dhe planet strategjike të përbashkëta që do të hartojnë, vlerësojnë dhe zbatojnë këto dy vende potenciale në fushën e turizmit.
- 3.3 Palët, në kohë të ndryshme sipas nevojës, mund të kërkojnë për t'u mbledhur për të shqyrtuar mbarëvajtjen e aktivitetëve të zhvilluara sipas këtij Memorandumi dhe për të planifikuar aktivitetet e ardhshme.
- 3.4 Palët mund të ftojnë njëra-tjetrën për të dërguar vëzhgues në mbledhje apo konferenca të thirrura nga to, apo nën kujdesin e tyre, në të cilat në mendimin e palës tjetër, tjetri mund të ketë një interes. Ftesat do të jenë subjekt i procedurave të zbatueshme për takime apo konferenca të tilla të përbashkëta që në thelb kanë promovimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit në fushën e trashëgimisë historike, kulturore e më gjerë.

Neni 4

Zbatimi i Memorandumit të Bashkëpunimit

- 4.1 Të gjitha aktivitetet e parashikuara më poshtë janë subjekt i disponueshmërisë së fondeve. Për këtë qëllim, në mënyrë që të zbatohen aktivitetet specifike të parashikuara më poshtë, palët do të nënshkruajnë marrëveshje për bashkëpunim kostosh në përputhje me rregulloret, rregullat dhe procedurat në fuqi të lidhura midis palëve në parim, të cilat do të specifikojnë kostot ose shpenzimet lidhur me aktivitetin dhe se si do të mbulohen ato nga Palët. Marrëveshjet për

bashkëndarjen e kostove duhet të kenë të inkorporuar një dispozitë që i referohet Memorandumit të Mirëkuptimit, që është e zbatueshme për marrëveshjet për bashkëndarje kostosh.

4.2 Të gjitha aktivitetet do të realizohen mbi bazën e Marrëveshjes së Financimit midis dy qyteteve, Bashkisë Elbasan dhe Komunës Preshevë, dhe në pajtim me rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat në fuqi të lidhura nga kjo marrëveshje dypalëshe.

4.3 Çdo Palë do të jetë përgjegjëse për veprimet dhe lëshimet në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi dhe zbatimin e tij.

Neni 5

Përdorimi i Emrit dhe Simboleve

5.1 Asnjë prej palëve nuk mund të përdorë emrin, simbolin dhe të drejtat e palës tjetër, ose të organeve mbështetëse, ose ndonjë shkurtim prej tyre pa shprehjen e aprovimit të shkruar të Palës tjetër në çdo rast.

5.2 Palët pranojnë dhe janë të njohura me idealet dhe objektivat e ndërsjellta, që emri dhe simbolet nuk mund të shoqërohen me çështje politike ose fetare, apo të përdoren në mënyrë të papranueshme me statusin.

5.3 Palët bien dakord për të njohur dhe pranuar këtë partneritet të parashikuar. Për këtë qëllim, Palët do të konsultohen me njera-tjetrën në lidhje me mënyrën dhe formën e kësaj njohjeje.

Neni 6

Afatet, Përfundimi, Rinovimi dhe Ndryshimi

6.1 Bashkëpunimi i propozuar në bazë të këtij Memorandum Mirëkuptimi është joekskluziv dhe do të ketë një afat fillestar për 2 vjet që nis nga data e hyrjes në fuqi, përveç nëse ndërpritet më herët nga secila palë me mbi dy muaj njoftim shkrim të Palës tjetër.

6.2 Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim mes Palëve.

Neni 7

Njoftimet dhe Adresat

Sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, çdo njoftim i nevojshëm ose kërkesë lejohet të jepet ose bëhet me shkrim. Njoftimi ose kërkesa do të konsiderohet e dhënë ose e bërë siç duhet nëse do t'i dorëzohet Palës tjetër dorazi, me postë të çertifikuar, me ndërlidhës brenda natës, faks, mesazh ose nëse i dërgohet në adresën e specifikuar poshtë ose në ndonjë adresë tjetër, e cila do të njoftohet në vazhdimësi.

Për Bashkinë Elbasan:

z. Gledian Llatja
Kryetar i Bashkisë Elbasan
Email: gledianllatja@elbasani.gov.al
Adresa: Rruga "Qemal Stafa",
Elbasan, Republika e Shqipërisë

Për Komunën Preshevë:

znj. Ardita Sinani
Kryetare e Komunës Preshevë
Email: kabineti@presevo.rs
Adresa: Rruga "Marshall Tito 36",
Preshevë,

Neni 8

Hyrja në Fuqi

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale dhe do të hyjë në fuqi në datën në të cilën nënshkruhet siç duhet nga të dy Palët ("data që hyn në fuqi").

SI DËSHMI E KËSAJ, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve nënshkruajnë më poshtë.

Për Bashkinë Elbasan

Për Komunën Preshevë

z. Gledian Llatja
Kryetar i Bashkisë Elbasan

znj. Ardita Sinani
Kryetare e Komunës Preshevë

Datë: _____

Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Elbasan më . 12. 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë ____ 12. 2024

**Për Propozimin e krijimit të bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Komunës
Preshevë, Serbi**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/12/2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur dhe pas reflektimit të dhënë nga Kryetari i Bashkisë në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji nr.43/2016 “Për Marrëveshjen Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”:

VENDOSI

1. Miratimin e propozimit të Krijimit të Bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Komunës Preshevë, Serbi.
2. Ngarkohet për zbatimin Kryetari i Bashkisë dhe Administrata e Bashkisë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: P.S.A.P

Pranoi: D.A.R

Miratoi: D.P.K.S.A.P.R

D.J.I

Sh.K

E. Stafa

J. Doçi

D. Roseni

A. Hoxha

E. Muço

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL, ARSIMIT DHE RINISË
DREJTORIA E ARSIMIT DHE RINISË
SEKTORI I ARSIMIT PARASHKOLLOR

Nr. 6879 Prot.

Elbasan, më 19.12. 2024

RELACION

Lënda: “Miratim dhënie burse për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional për vitin shkollor 2024-2025”

KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

Të nderuar këshilltarë:

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në VKM nr.666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik” i ndryshuar me VKM-në nr.511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”; Shkresës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr.13089/1 prot. datë 23.10.2024 “Dërghet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin klasën e 10-të në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2024–2025”, shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr.7228/33 prot, datë 18.11.2024 “Dërgohet plani i busave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024 -2025”, si dhe mbështetur në Urdhërin e Brendshëm nr.909 datë 21.10.2024, “Për ngritjen e komisionit që do të shqyrtojë kërkesat e nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për përfitimin e bursave për vitin shkollor 2024-2025” nga kryetari i bashkisë, ju paraqesim relacionin mbi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për burse të ardhura në Bashkinë Elbasan nga nxënësit të cilët ndjekin arsimin parauniversitar në shkollat e bashkisë Elbasan dhe nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar në bashkitë e tjera por vendbanimin e tyre të përhershëm e kanë në Elbasan.

Në muajin shtator, sektori i arsimit pranë Drejtorisë së Arsimit dhe Rinisë, dërgoi një e-mail në adresat zyrtare të të gjitha shkollave të arsimit 9-vjecar, arsimit të mesëm të përgjithshëm (përfshirë këtu edhe arsimin e mesëm të bashkuar) dhe arsimit të mesëm profesional në juridiksionin e saj, për hapjen dhe pranimin e aplikimeve për bursë për të gjithë nxënësit të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe që plotësojnë kriteret sipas VKM-së nr.666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik” ndryshuar me VKM-në 854/2019 dhe VKM-në 511/2022.

Shkollat ku pati aplikime nga nxënësit, sollën me shkresë zyrtare listën emërore të nxënësve aplikues dhe kërkesën për miratim burse drejtuar bashkisë Elbasan, bashke me dokumentacionin e dorëzuar nga cdo nxënës pranë shkollës.

Në total, pranë bashkisë Elbasan, sollën kërkesat e tyre për miratim burse 32 shkolla. Numri i nxënësve aplikues për vitin shkollor 2024–2025 është 1099 nxënës. Shkollat ku pati aplikime dhe numri i nxënësve aplikues për cdo shkollë është si më poshtë vijon:

Institucioni	Numri i aplikimeve	Totali
I. ARSIMI I MESEM PROFESIONAL (kuotë financiare)		
Shkolla e mesme profesionale Elbasan	597	597
II. ARSIMI BAZË & ARSIMI I MESEM I PËRGJITHSHËM (kuotë financiare)		
Shkolla 9-vjecare Kuqan	2	355
Shkolla “Abdulla Keta”	1	
Shkolla “Adem Krasniqi”	10	
Shkolla “Ali Agjah”	5	
Shkolla “Alush Lleshanaku”	7	
Shkolla “Bardhyl Popa”	5	
Shkolla “Fadil Gurmani”	14	
Shkolla “Jeronim de Rada”	28	
Shkolla “Sul Harri”	3	
Shkolla “Naim Frashëri”	11	
Shkolla “Xhemal Jance”	4	
Shkolla “Ptoleme Xhuvani”	5	
Shkolla “Jorgji Dilo”	26	
Shkolla “Sul Misiri”	12	
Shkolla “Qamil Guranjaku”	3	
Shkolla “Shushice”	5	
Shkolla “Kodhel Dedja”	3	
Shkolla “Kostandin Shpataraku”	1	
Shkolla “Ahmet Dakli”	9	
Shkolla “Dhaskal Todri”	42	
Shkolla “Kostandin Kristoforidhi”	44	
Shkolla “Mahir Domi”	23	
Shkolla “Mahmud dhe Ali Cungu”	9	
Shkolla “Vasil Kamami”	10	
Shkolla “Anastas Cakalli”	4	
Shkolla “Luigj Gurakuqi”	39	
Shkolla “Onufri”	4	
Shkolla “Sali Ballkoci”	6	
Shkolla “Ibrahim Bozhiqi”	17	
Shkolla “Sulejman Rranci”	1	
Pa vërtetim shkolle	2	
III. ARSIMI SPECIAL (kuotë veshmbathje)		
Shkolla “Zëra Jete”	54	54
IV. Nxënës që ndjekin studimet në bashkitë e tjera por vendbanimin e kanë në Elbasan.		
Nxënës aplikues	4	4
TOTAL		1010

Për vitin shkollor 2024-2025 Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit akordoi për bashkinë Elbasan 190 bursa për nxënësit e regjistruar në klasat e X në shkollat e mesme profesionale ndërsa Ministria e Arsimit dhe Sportit, akordoi 200 bursa për nxënësit që ndjekin arsimin bazë dhe të mesëm dhe që plotësojnë kriteret sipas VKM-së nr.666/2019 i ndryshuar. Bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM-në nr.666/2019 i ndryshuar me VKM-në 854/2019 dhe VKM-në 511/2022, komisioni mori në shqyrtim dosjen e cdo aplikanti dhe hartoi listën emërore, bashkëlidhur këtij relacioni, të nxënësve të arsimit parauniversitar të cilët plotësojnë kriteret në VKM.

Për sa më sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë bursa si më poshtë vijon:

I. ARSIMI I MESËM PROFESIONAL (aplikime për bursë me kuotë financiare)

597 nxënës aplikues;

- 179 nxënës aplikues janë për herë të parë;
- 418 nxënës aplikues janë përfitues burse edhe në VKB-të e mëparshme;

Nga sa më sipër:

→ 471 nxënës aplikues, plotësojnë kriteret sipas VKM-së nr.666/2019 i ndryshuar;

- 132 nxënës aplikojnë për herë të parë;
- 339 nxënës janë përfitues burse edhe në VKB-të e mëparshme;
 - 193 nxënës, Kriteri Ekonomik / Distanca 5km & të ardhura për frymë sipas pasqyrës 1;
 - 98 nxënës, Kriteri Joekonomik / Komuniteti rom & egjiptian;
 - 73 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. me Prindin me Status invalidi;
 - 21 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. ka Status para-tetraplegjik & AK;
 - 28 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. me 1 prind që nuk jeton më;
 - 9 nxënës, Kriteri i Degëve Parësore të Zhvillimit Ekonomik, dega “Ndërtim”;
 - 27 nxënës, Kriteri i rezultateve të arritura;
 - 2 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. ka kumbur kujdestarine prinderore;
 - 20 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. Vajza që ndjekin AP (përvec degëve të pikës F)

→ 126 nxënës aplikues, NUK plotësojnë kriteret sipas VKM-së ose kanë mungesa në dokumentacionin e aplikimit;

- 47 nxënës aplikojnë për herë të parë;
- 79 nxënës janë nga përfituesit në VKB-të e mëparshme;
 - 2 nxënës e kanë vendbanimin në bashkitë e tjera dhe në klasë të 10 duhet të aplikojnë në bashkinë ku kanë vendbanimin e përhershëm;
 - 1 nxënës është jashtë trungut familjar;
 - 18 nxënës nuk plotësojnë distancën 5km;
 - 42 nxënës kanë të ardhura për frymë mbi kufirin në pasqyrën nr.1 të VKM-së ose nuk vërtetojnë të ardhurat për frymë.
 - 18 nxënës kanë vërtetim aktiviteti privat në emër të prindërve të tyre;
 - 44 nxënës kanë mangësi në dokumentacion,
 - 1 nxënës është përsëritës pasi ka mbetur në klasë vitin e kaluar;

II. ARSIMI 9-VJECAR & ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM (aplikime për bursë me kuotë financiare)

355 nxënës aplikues;

Nga këto:

- 200 nxënës aplikues, plotësojnë kriteret sipas VKM-së nr.666/2019 i ndryshuar.
 - 18 nxënës, Kriteri ekonomik / Braktises;
 - 4 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx ka Status Jetim
 - 1 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. ka kumbur kujdestarine prinderore;
 - 33 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. ka Status para-tetraplegjik & AK;67 nxënës,
 - 66 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. me Prindin me Status invalidi;
 - 78 nxënës, Kriteri Joekonomik / Nx. me 1 prind që nuk jeton më;
- 155 nxënës aplikues, NUK plotësojnë kriteret sipas VKM-së;
 - 1 nxënës ka të ardhura për frymë mbi kufirin në pasqyrën nr.1 të VKM-së.
 - 1 nxënës është përsëritës pasi ka mbetur në klasë vitin e kaluar;
 - 153 nxënës kanë mangësi në dokumentacion;

III. SHKOLLA E ARSIMIT SPECIAL “ZËRA JETE” (aplikime për bursë me kuotë veshmbathje)

54 nxënës aplikues që plotësojnë kriterin;

Në shkollën speciale “Zëra jete” kanë aplikuar 54 nxënës me Aftësi Ndyshe të cilët janë përfitues sipas pasqyrës nr.4 për kuotat financiare të veshmbathjes në VKM-në nr.666/2019 i ndryshuar.

IV. NXËNËS QË NDJEKIN STUDIMET NË BASHKITË E TJERA.

4 nxënës aplikues që plotësojnë kriterin;

Konceptoi komisioni:

E.Stafa, SPA

Jona Gjini, SPA

Miranda Duka,

Ana Vrioni, SJ

Pranoi: Drejtori DPKSAPR, D.Rroseni

NËNKRYETARI

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____.____.2024

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë: _____.____.2024

“Për miratim dhënie burse, për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional, për vitin shkollor 2024-2025”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____.____.2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit dhe Rinisë “*Miratim dhënie burse, për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional për vitin shkollor 2024-2025*”, mbështetur në nenin 54 të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar), në VKM nr.666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” (i ndryshuar) dhe me propozim të Komisionit të shqyrtimit të bursave të ngritur me Urdhrin nr.909 datë 21.10.2024 “Për ngritjen e komisionit që do të shqyrtojë kërkesat e nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për përfitimin e bursave për vitin shkollor 2024-2025” të Kryetarit të Bashkisë;

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e bursave, për nxënësit e shkollave të arsimit bazë, arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe të arsimit profesional, për vitin shkollor 2024-2025, sipas tabelave bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, pranë Bashkisë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elvi Cuni

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi:

Drejtoria e DAR,

Drejtoria e DPKSAPR,

Drejtoria Juridike:

Zv/kryetar:

J.Doci

D.Roseni

A. Hoxha

A.Shehu

Lista emërore e nxënësve përfutues burse për vitin shkollor 2024 - 2025 , në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm.

Nr	Emër	Atesi	Mbiemër	Institucioni arsimor	Klasa	Kriteri	Bashkia	Bursa
1	Aleksandra	Ilir	Zeneji	Adem Krasniqi	2	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
2	Silvana	Nikolin	Binjaku	Adem Krasniqi	2	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
3	Anxhela	Nikolin	Binjaku	Adem Krasniqi	5	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
4	Albi	Argjendar	Kyçyku	Adem Krasniqi	1	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
5	Arta	Argjendar	Kyçyku	Adem Krasniqi	3	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
6	Klervis	Juljan	Mullisi	Adem Krasniqi	7	2.3/d Kriteri joekonomik / Nxënës femijë të personit/personave që gëzojnë Statusin e Invalidit	Eibasan	E plotë
7	Famirra	Juljan	Mullisi	Adem Krasniqi	3	2.3/d Kriteri joekonomik / Nxënës femijë të personit/personave që gëzojnë Statusin e Invalidit	Eibasan	E plotë
8	Orges	Martin	Lijci	Adem Krasniqi	2	2.1/c Kriteri ekonomik / Nxënës Braktisës	Eibasan	E plotë
9	Joel	Fatmir	Bani	Adem Krasniqi	5	2.3/d Kriteri joekonomik / Nxënës femijë të personit/personave që gëzojnë Statusin e Invalidit	Eibasan	E plotë
10	Ritza	Ndricim	Xibraku	Adem Krasniqi	6	2.3/d Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
11	Noam	Qemal	Lala	Ali Aglah	7	2.3/c Kriteri joekonomik / Nxënës me Aftësi të Kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor.	Eibasan	E plotë
12	Roena	Roland	Gucej	Ali Aglah	9	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
13	Ina	Roland	Gucej	Ali Aglah	8	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
14	Orion	Roland	Gucej	Ali Aglah	4	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
15	Marina	Ermond	Sina	Alush Lleshanaku	8	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
16	Esmeralda	Sajmir	Lleshanaku	Alush Lleshanaku	4	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
17	Artenisa	Bashkim	Rreshka	Abdulla Keta	3	2.1/c Kriteri ekonomik / Nxënës Braktisës	Eibasan	E plotë
18	Erina	Mentor	Musabelliu	Barthyl Popa	7	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
19	Jusuf	Mentor	Musabelliu	Barthyl Popa	9	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
20	Sidri	Skender	Tufa	Barthyl Popa	7	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
21	Antonela	Alfred	Gjolena	Barthyl Popa	6	2.3/c Kriteri joekonomik / Nxënës me Aftësi të Kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor.	Eibasan	E plotë
22	Aurela	Ervin	Filja	Fadil Gurrmani	9	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
23	Florenc	Ervin	Filja	Fadil Gurrmani	6	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
24	Sibora	Mexhit	Illita	Fadil Gurrmani	6	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
25	Enejda	Mexhit	Illita	Fadil Gurrmani	3	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
26	Suada	Mexhit	Illita	Fadil Gurrmani	5	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
27	Amelja	Fatos	Shpau	Fadil Gurrmani	6	2.3/d Kriteri joekonomik / Nxënës femijë të personit/personave që gëzojnë Statusin e Invalidit	Eibasan	E plotë
28	Abigela	Besnik	Shushku	Fadil Gurrmani	6	2.3/d Kriteri joekonomik / Nxënës femijë të personit/personave që gëzojnë Statusin e Invalidit	Eibasan	E plotë
29	Ajsolda	Besnik	Shushku	Fadil Gurrmani	9	2.3/d Kriteri joekonomik / Nxënës femijë të personit/personave që gëzojnë Statusin e Invalidit	Eibasan	E plotë
30	Marina	Kostandin	Qosja	Fadil Gurrmani	9	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
31	Marjano	Kostandin	Qosja	Fadil Gurrmani	7	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
32	Raila	Elvis	Totoshi	Fadil Gurrmani	8	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
33	Ereca	Kamber	Qosja	Fadil Gurrmani	8	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
34	Klasja	Guri	Muca	Jorgji Dilo	9	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
35	Klea	Guri	Muca	Jorgji Dilo	9	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
36	Tea	Ceri	Santo	Jorgji Dilo	8	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
37	Aleksandra	Centan	Hajredini	Jorgji Dilo	6	2.3/g Kriteri joekonomik / Nxënës me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton	Eibasan	E plotë
